



Me propozimin e Kryetarit të Komunës së Deçanit, z.Bashkim Ramosaj, në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), dhe nenit 58 të Ligjit, Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008", në përputhje me nenin 3, paragrafi 3.3 të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008) dhe dispozitave të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012), i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, e në mbështetje të neneve 15 dhe 27 paragrafi 3, shkronja (i) dhe nenit 56 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01-Nr-IX-5, i datës 31.10.2019, në përputhje me Ligjin Nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare publikuar me dt.24.05.2018, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen urgjente të mbajtur me datën, 19.07.2021, miraton këtë:

V E N D I M

PËR INICIMIN E PROCEDURËS PËR THEMELIMIN E NDËRMARRJES PUBLIKE KOMUNALE "UJËSJELLËSI" Sh.A, PËR MENAXHIMIN E UJIT TË PIJES NË KOMUNËN E DEÇANIT

- 1.Me këtë Vendim miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për Inicimin e procedurës për themelimin e Ndërmarrjes Publike Komunale "Ujësjellësi" Sh.A. për menaxhimin e ujit të pijes në Komunën e Deçanit.
- 2.Kuvendi i Komunës së Deçanit themelon Komisionin për hartimin e normave të duhura deri në Aktin e themelimit dhe regjistrimin si NLP, ku Komuna është 100% aksionare.
- 3.Komisioni ka përgjegjësi që pas Aktit të themelimit t'i trajtoj të gjitha procedurat ligjore-administrative deri në shkëputje të Ndërmarrjes Publike Komunale "Ujësjellësi" Sh.A nga "Hidrodrini" K.R.U.
- 4.Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit dhe Drejtoritë kompetente Komunale.

A r s y e t i m:

Ky Vendim vjen si pasojë e keq menaxhimit të rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Deçanit nga "Hidrodrini" K.R.U. e që ka të bëjë me aspekte teknike ndërtimore që nga qasja në burim, mos standardizimin e rezervarëve të ujit, puseta të ujit, rrjetit të ujësjellësit e deri te kyçjet ilegale e mos pasjen e orë matësve për regjistrimin e shpenzimit të ujit.

Të gjitha këto mangësi të cekura në Arsyetim kanë sjellë rrjedhimisht për pasojë cenimin e cilësisë së ujit, gjë e cila ka krijuar situatën e infektimit dhe helmimit me ujë në Komunën e Deçanit të mbi 2000(dy mij) qytetarëve.

5.Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen:MAPL, Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.X-1

Deçan,dt.19.07.2021



Kryesuesi i Kuvendit :
Haki Shehaj

K.K. Deçan AS

21827